



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 26
Prishtinë, më 4 prill 2016, në orën 16:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Enver Hoxhaj, Qerim Bajrami, Elmi Reçica, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca e Zafir Berisha.

Munguan: Teuta Rugova dhe Blerta Deliu- Kodra.

Në takim, ishin të pranishëm, nga Parlamenti Gjerman, deputetët: Andreas G. Lämmel, Josip Juratović, Peter Weiß dhe zëvendësambasadorja e Gjermanisë në Kosovë, Christina Gehlsen.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

Takim i Komisionit me delegacionin e Grupit të Miqësisë, të Parlamentit Gjerman, për marrëdhëniet me shtetet e Evropës Juglindore.

Enver Hoxhaj, i dëshiroi mirëseardhje dhe e falënderoi delegacionin e Grupit të Miqësisë, të Parlamentit Gjerman, për marrëdhëniet me shtetet e Evropës Juglindore, për vizitën e realizuar në Kosovë.

Peter Weiß, prezantoi anëtarët e delegacionin të Grupit të Miqësisë, të Parlamentit Gjerman, për marrëdhëniet me shtetet e Evropës Juglindore. Kërkoi që të njoftohet për perspektivën e integritetit evropian të Kosovës dhe klimën politike në Kuvend.

Enver Hoxhaj, shprehu respektin e institucioneve dhe të popullit të Kosovës, për ndihmën e vazhdueshme të Gjermanisë dhe të popullit gjerman, dhënë Kosovës. Theksoi se të gjithë anëtarët e Komisionit, duke përfshirë edhe ata të opozitës, janë pa përjashtim, pro evropianë. Bëri të ditur se pas nënshkrimit të MSA-së, në proceset e mëtejme, Kosovën mund ta presë një sfidë nga pesë shtetet e BE-së, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën. Lidhur me liberalizimin e vizave, tha se Kosova ka ngelur ende e izoluar, dhe se të gjitha 101 kriteret për liberalizimin e vizave, janë përmbushur. Sa i përket dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, theksoi se dialogu duhet të

vazhdojë, por me parametra të qartë. Njoftoi se nga 18 marrëveshjet e arritura, deri më tani në Bruksel, vetëm disa nga ato kanë filluar të zbatohen nga Serbia.

Glauk Konjufca, mes tjerash, tha se sfida sistematike dhe afatgjate që e përcjell Kosovën në procesin e shtet-ndërtimit dhe afirmimit ndërkombëtar të saj, janë pamundësi e krijimit të një sistemi kredibil gjyqësor, e cekur edhe në vërejtjet e vazhdueshme të Raportit të Progresit për Kosovën; dështimi i luftimit të korrupsionit nga organet vendore dhe EULEX-i, si dhe varfëria e papunësia e madhe në rritje. Momente të tjera sfiduese, sipas tij, ka pasur gjatë vitit të kaluar me votimin kundërligjor të Gjykatës Speciale, e cila është njëdimensionale, sepse do të merret vetëm ndaj pjesëtarëve të UÇK-së. Po ashtu, marrëveshja për krijimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe, tha se është projektuar në parime joevropiane, siç është paracaktimi etnik i posteve të rëndësishme publike dhe segregacioni i një pjese tjetër të popullsisë. Çështje tjetër, që ka shqetësuar një pjesë të madhe të popullit të Kosovës dhe subjekte të caktuara politike, tha se është demarkacioni i kufirit me Malin e Zi.

Ismet Beqiri, theksoi se asnjëherë nuk është e mjaftueshme, që të falënderojmë Gjermaninë dhe shtetet mike, për ndihmën që i kanë dhënë Kosovës. Duke u ndërlidhur me veprimet në Kuvend, tha se ato janë të papranueshme dhe se i kanë dhënë një imazh jo të mirë vendit. Bëri të ditur se partia e tij nuk ka qenë e entuziazmuar me disa marrëveshje që janë arritur në Bruksel, por është angazhuar që ato të vazhdojnë, me qëllim të përmbushjes së obligimeve të mëhershme, të dala nga Kuvendi.

Zafir Berisha, në diskutimin e tij, theksoi se populli i Kosovës është historikisht evropian dhe se dëshiron që të integrohet në familjen evropiane. Sa u përket përplasjeve në Kuvend, tha se si në çdo vend tjetër, ashtu edhe tek ne ka përplasje në mes të pozitës e opozitës, të cilat kanë ndodhur në mungesë transparence nga bisedimet në Brukselit, për arritjen e disa marrëveshjeve. Nga praktikat në rajon, z. Berisha tha se marrëveshja për asociacionin mund të jetë me probleme afatgjate, që nuk i konvenon as Ballkanit, e as Evropës. Ndërsa, duke u ndërlidhur me raportet rajonale, tha se politika në Serbi është ende peng i së kaluarës historike, që po reflekton edhe në politikën rajonale.

Qerim Bajrami, delegacionit i dëshiroi mirëseardhje dhe e falënderoi për ndihmën që Gjermania i ka ofruar Kosovës, e cila ndihmë tha se beson se do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Bëri të ditur se në Gjermani jeton 1/4 e popullatës së Kosovës, si shqiptarë ashtu edhe boshnjakë, e cila diasporë është një urë lidhëse shumë e mirë në mes të Kosovës e Gjermanisë. Duke u ndërlidhur me dialogun në mes të Kosovës e Serbisë, në Bruksel, tha se marrëveshjet e arritura shpreson se do të përfundojnë dhe se Serbia do t'i kryej obligimet ndaj nesh, të dala nga këto marrëveshje. Pyeti zëvendës-ambasadorin për mundësitë e punësimit sezonal të të rinjve kosovarë në shtetin gjerman dhe mundësinë e investimeve në Kosovë.

Elmi Reçica, theksoi se jemi shumë mirënjohës për gjithë veprimet që i ka bërë Gjermania, në të gjitha fazat e zhvillimeve historike. Kosova, si një shtet i ri, ka nevojë që në rrugëtimin e saj për integrim në BE dhe NATO, ta ketë ende mbështetjen dhe është i bindur se Bundestagu gjerman, do ta mbështesë popullin tonë në këto synime të ligjshme. Çështje tjetër, z. Reçica ngriti nevojën për punësim të qytetarëve tanë në Gjermani, që do të mund të arrihej përmes marrëveshjeve në mes të dy vendeve. Ai, po ashtu, theksoi se brenda infrastrukturës ligjore dhe në bashkëpunim me miqtë tanë, do të angazhohen për të avancuar statusin e Kosovës drejt integriteteve euroatlantike.

Peter Weiß, lidhur me gjendjen jostabile politike në Kosovë, u shpreh se nuk dëshiron t'u japë mësim miqve kosovarë, por ua ka kujtuar atyre dështimin e Republikës së parë demokratike të Vajmarit, pikërisht për shkak të zënkave të papajtueshme të partive politike gjermane. Ndërsa, për nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të MSA-së, tha se është shumë e rëndësishme për Kosovën,

ndërkaq u zotua se Bundestagu gjerman do ta mbështesë Kosovën në liberalizimin vizave dhe shprehu gatishmërinë për lobim për integrim evropian të Kosovës.

Josip Juratoviç, në diskutimin e tij, tha se procesi i integrimit evropian duhet të shpejtohet, po ashtu edhe procesi i liberalizimit të vizave. Rëndësi e posaçme duhet kushtuar bashkëpunimit rajonal, të punohet në mënyrë konstruktive dhe të gjinden zgjidhje për të gjithë së bashku. Pa bashkëpunim rajonal, nuk do të ketë zhvillim ekonomik apo zhvillim tjetër pozitiv, tha z. Juratoviç. Institucioni më i rëndësishëm në demokraci, tha se është Kuvendi dhe ai nuk duhet të bojkotohet apo dëmtohet, sepse ai është institucion i shenjtë dhe duhet respektuar dhe të ketë kompromis.

Andreas G. Lämmel, bëri të ditur se brenda Grupit të Miqësisë kanë një grup për Ballkanin Perëndimor, i cili ka për qëllim që në muajin shator, të japë një pozicion lidhur me procesin e anëtarësimit të shteteve të Ballkanit dhe të Kosovës. Z. Lämmel, tha se për të është e papranueshme ajo çka ka ndodhur në Kuvend, ngase e dëmton imazhin e vendit. Sa i përket migrimit, tha se është e rëndësishme që kryeministri do të ripranojë të gjithë refugjatët e Kosovës. Lidhur me zhvillimin ekonomik, tha se kosovarët duhet të punojnë në Kosovë dhe të presin investitorët. Njoftoi për një studim lidhur me ndikimet e islamizmit radikal në Kosovë, dhe nëse ky studim është i vërtetë, tha se ka shumë pjesëmarrës që janë nga Kosova, që luftojnë në kuadër të ISIS-it.

Enver Hoxhaj, tha se ne jetojmë në një kohë globale, ka kroatë nga Kroacia që shkojnë e luftojnë në Ukrainë për palën ukrainase, ka serbë nga veriu i Mitrovicës, që shkojnë e luftojnë për palën ruse, ka shqiptarë, boshnjakë, maqedonas, e tjerë që marrin pjesë në luftimet e ISIS-it. Këto janë kërcënimet globale, me të cilat ne do të ballafaqohemi, ndërsa ne si shoqëri, nuk kemi ndryshuar asgjë në identitetin tonë dhe islami nuk mund të ketë fare ndikim në kulturën tonë, tha kryetari Hoxhaj. Izolimi ynë është i përmasave dramatike. Jemi në një status quo, sepse pesë vende të BE-së ende nuk e kanë njohur Kosovën dhe nuk mund të anëtarësohemi në organizata ndërkombëtare, por shpresojmë që së bashku do t'i tejkalojmë këto sfida.

Elmi Reçica, bëri të ditur se sa i përket terrorizmit, ai është i dënueshëm në Kosovë, kemi bazë ligjore për t'i parandaluar ato veprime. Po ashtu, njoftoi se numri i atyre që shkojnë për të luftuar jashtë vendit është në rënie.

Christina Gehlsen, njoftoi se është duke punuar në mes të palës gjermane dhe Qeverisë së Kosovës, për arritjen e mundësisë së punësimit sezonal të qytetarëve të Kosovës në Gjermani, nga 1 janari 2017.

Enver Hoxhaj, e falënderoi delegacionin për takimin dhe i njoftoi se Kuvendi i Republikës së Kosovës, shumë shpejt do ta krijojë Grupin e Miqësisë me Bundestagun gjerman.

Mbledhja përfundoi në orën 17:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Enver Hoxhaj